



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4240/20 datë:18.02.2020



Npi – 01/55 datë: 27.02.2020

Bazuar në nenin 12.2. pika (d) dhe nenin 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Dhe sipas kërkesës së MAPL-së Nr.43-1138/6 dt.20.01.2020 për rishqyrtimin e Ligjshmërisë të Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Npi-01/312, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2020, Aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA
PËR VITIN 2020, Npi – 01/312 SIPAS KËRKESËS SË MAPL-së**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më: 27.02.2020, unanimisht aprovoi Vendimin për ndryshimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2020, Npi – 01/312 datë: 31.10.2019, si vijon:

1. *Nenin 7.3, Largohet (hiqet) nga Rregullorja.*

Sipas legjislacionit në fuqi kjo është tani kompetencë e Institucioneve qendrore.

2. *Neni 10.2 i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2020, Ndryshohet dhe bëhet si vijon: “Duke u bazuar në U.A. Nr.04/2007, të datës 24.09.2007, dhe U.A. Nr.04/2013 për Çertifikatat Shëndetësore i datës 15.05.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesa e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore, çmimorja e pagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit paresor është”:*

3. *Neni 10.2.18, Largohet (hiqet) nga Rregullorja.*

4. *Neni 10.2.19, Ndryshohet shuma e pagesës nga: 18€ në 15euro.*

5. *Neni 13 i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2020, ndryshohet teksti nga: “Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, marrjen e lejes për shfrytëzim” në: “Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, për personat fizik, marrjen e lejes për shfrytëzim. Ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtjes me gjobë”.*

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj